

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Tonka Berishaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.T., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për krime të rënda, PKR.nr.76/15 datë 15.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18. 07. 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për krime të rënda, PKR.nr.76/15 datë 15.05.2018 vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.76/18 datë 15.05.2018, të akuzuarin N.T. e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet , me kusht që në afat prej një viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së . Shpenzimet e procedurës penale është detyruar i akuzuari N.T. që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 30 euro në emër të paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Themelore – Departamenti për krime të rënda në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, për shkak të shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 të KPPRK-së, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal nga neni 383 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 387 paragrafi 1 të KPP-së, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.76/18 të datës 15.05.2018 ta anulojë, ndërsa lëndën ta kthejë në rigjykim në shkallën e parë për eliminimin e shkeljeve , ose aktgjykimin ta ndryshojë, ashtu që të

akuzuarit N.T. ti shqiptojë një sanksion penal proporcional me mënyrën e kryerjes së veprës penale , përgjegjshmërinë dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.272/18 të dt.18.06.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, e cila shkelje qëndron në atë se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me nenin 370 par.4 të KPP-së sepse nuk janë paraqitur të dhëna të sakta lidhur me dënimin e shqiptuar. Po ashtu shkelje esenciale paraqet edhe fakti se dispozitivi i aktgjykimit në faqen e dytë është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit, arsyetimi ka paqartësi sa i përket shumës së paushallit gjyqësor që duhet ta paguajë i akuzuari. Aktgjykimi ankimohet edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, neni 385 par.1 nënpar 1.6 të KPPRK-së e cila qëndron në atë se gjykata edhe pse e ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet , me kush që në afat prej një viti i akuzuari të mos kryejë vepër tjetër penale, gjykata nuk e ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak të akuzuarit N.T., kjo do të paraqet paqartësi në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, a do të vuajë dënimin prej 180 ditësh apo do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe nën masën e arrestit shtëpiak. Prokuroria konsideron se edhe përkundër pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, gjykata nuk i ka shqiptuar të akuzuarit dënimin e merituar sipas ligjit, sepse këtë dënim e zbuti deri në atë masë e cila bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen, caktimin, dhe abutjen e dënimit të përcaktuar me nenin 73, pastaj ato të zbutjes së dëimit dhe kufijtë e kësaj zbutje të përcaktuara me nenet 74 e 75 dhe 76 të KPRK-së. Sa i përket vendimit mbi dënim Prokuroria thekson se gjykata ka përmendur rrethanat lehtësuese për të cilat nuk ka dhënë kurrfarë arsyetimi që do ta arsyetonin dënimin e shqiptuar, dhe nuk janë vlerësuar rrethanat rënduese, ato as që janë përmendur, e sikur gjykata të kishte vlerësuar rrethanat rënduese si shkalla e përgjegjësisë penale, dashja, mjeti i kryerjes së veprës penale, shkop druri, lëndimet trupore në kokë të të dëmtuarit M.T. i cili është i shtyrë në moshë, këmbëngulësia e të akuzuarit N., përkitazi me këto gjykata e shkallës së parë është dashur ti shqiptojë një dënim me burgim efektiv më të gjatë të akuzuarit N.T., dënim i cili do të ishte në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, mënyrën e kryerjes, dhe lëndimet e shkaktuara. Duke i pasur parasysh këto Prokuroria pretendon se me dënimin që i është shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk do të parandalohet kryerja e veprave penale kundër jetës dhe trupit e që në regjionin e Gjilanit janë në rritje e

sipër, dhe nuk do të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal i përcaktuar me nenin 41 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, në ndërkohë ka pranuar një aktvendim përmirësues nga Gjykata Themelore në Gjilan me të cilën përmirësohet aktgjykimi PKR.nr.76/18 i datës 15.05.2018 ashtu që në dispozitivin e aktgjykimit në faqen e dytë menjëherë pas pasusit të parë duhet të shënohet -në rast të revokimit të dënimit me kusht të pandehurit do ti llogaritet edhe koha e qëndrimit në arrest shtëpiak prej datës 12.03.2018 deri më datën 12.04.2018 si dhe në arsyetimin e aktgjykimit në faqen 3 pasusi i tretë, rreshti i dytë në vend të shumës paushallë prej 20 euro duhet të jetë 30 euro. Prandaj meqë aktvendimi për përmirësim aktgjykimi ka ardhur para se kjo gjykatë të vendosë lidhur me ankesën e Prokurorisë, kjo gjykatë vlerëson se janë evituar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesën e Prokurorisë, prandaj kjo gjykatë ankesën e vlerësoi vetëm përkitazi me vendimin mbi dënim.

Meqë u vërtetua se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të Prokurorisë lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e Prokurorisë nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Prokuroria thekson se gjykata nuk i ka shqiptuar të akuzuarit dënimin e merituar sipas ligjit pasi kjo bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen, caktimin, dhe zbutjen e dënimit nga neni 73,74,75,76 të KPRK-së. Dhe se me dënimet e tilla nuk mund të parandalohet kryerja e veprave penale kundër jetës dhe trupit e që janë në rritje në regjionin e Gjilanit. Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë, pendimin e tij për veprën e kryer, kërkim falja si dhe premtimi se nuk do ta përsërisë veprën penale por edhe se është njeri familjar, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimet nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.292/2018, më 18.07.2018

Procesmbajtës,
Syzana Goxhuli_____

Kryetari i kolegjit- gjyqtarja
1. Tonka Berishaj

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Have Haliti_____